



Arsyetim

i Vendimit për lartësinë e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të ekspozimit ndaj vendeve të tjera

(“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 175/ 22)

Me vlerësimin e rregullt tremujor të rreziqeve sistematike, i cili përfshin të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2022, duke përfshirë treguesit më të fundit, u vlerësua se është e nevojshme **të vendoset norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në lartësi prej 0,5%. Kjo masë do të fillojë të zbatohet nga data 1 gusht 2023, që ofron hapësirë të mjaftueshme për bankat për t'u përshtatur dhe për formimin gradual të shtresës mbrojtëse të kapitalit pa efekte negative në mbështetjen solide të kredisë për ekonominë.**

Vendosja e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut bëhet me qëllim të forcimit të mëtejshëm të stabilitetit financiar në kushtet e rritjes graduale të rreziqeve sistematike. Me vendosjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, merren masa parandaluese dhe forcohet më tej fuqia kapitale e bankave vendase, e cila është baza e rezistencës së sektorit bankar ndaj rreziqeve.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore), kryen vlerësim të rrezikut sistematik ciklik dhe përcaktimon sasinë e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit (ShMKK) për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut Banka Popullore përmes analizave të treguesve bazë dhe shtesë për rrezikun sistematik. Treguesi bazë i përdorur për të përcaktuar shumën e normës ShMKK-së për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut është devijimi i raportit ndërmjet kredive të dhëna për sektorin jofinanciar të vendit dhe produktit të brendshëm bruto nga tendenca e tij afatgjatë. Nëse devijimi është mbi 2 pikë përqindjeje, është sinjal për vendosjen e normës së ShMKK-së për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut më e madhe se zero. Për shkak të analizës gjithëpërfshirëse të rrezikut sistematik, Banka Popullore, në pajtueshmëri me standardet europiane, merr parasysh tregues të tjerë shtesë, siç janë treguesit e tregut financiar, rezistencën e sistemit bankar, ekonominë vendase, tregun e pasurive të paluajtshme e të ngjashme. Analiza e treguesve shtesë është po aq e rëndësishme, sepse zbulon burimet e tjera të rreziqeve, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me dinamikën e ciklit të kredisë dhe mund të nxisin natyrën ciklike të rrezikut të kredisë.

Sipas vlerësimeve të fundit, në fund të tremujorit të parë të vitit 2022, treguesi bazë është ende brenda kufijve të pranueshëm,

respektivisht, norma e kredisë është ende nën prirjen e saj afatgjatë.

Aktiviteti kreditues i bankave që nga fillimi i vitit është përshpejtuar mesatarisht, i cili më së shumti rezulton nga rritja e kredisë për sektorin e korporatave. Kjo kontribuon pozitivisht në ruajtjen e likuiditetit të sektorit të korporatave në kushtet e çmimeve gjithnjë e më të larta të energjisë dhe produkteve parësore, duke rritur kështu nevojat për financim.

Në segmentin e avisërive, mbështetja kreditore ruhet në nivel të qëndrueshëm prej rreth 8% në bazë vjetore. Megjithatë, ritmi i rritjes së kredisë për banesa është i lartë dhe ka qenë në nivelin rreth 14% për periudhë më të gjatë, kështu kredia për banesa vijon të ketë kontribut më të madh në rritjen e kreditimit të popullsisë me afër 60%. **Në të njëjtën kohë, rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme përshpejtohet, ku një pjesë e transaksioneve të pasurive të paluajtshme financohen me kredi.** Portofoli i kredisë për strehim është i shëndetshëm dhe i cilësisë më të lartë dhe për momentin nuk ka shenja të materializimit të rrezikut të kredisë, por mjedisi i pasigurt makroekonomik thekson rreziqet për periudhën e ardhshme.

Burimi kryesor i rreziqeve mjedisore është lufta në Ukrainë, e cila, në varësi të kohëzgjatjes dhe intensitetit të goditjes gjeopolitike, mund të përkeqësojë perspektivën për aktivitetin e brendshëm ekonomik dhe inflacionin. Kjo do të kishte ndikim negativ në funksionimin e kompanive dhe në standardin e jetesës dhe fuqinë blerëse të popullsisë, gjë që mund të ndikojë në aftësinë për të shlyer rregullisht detyrimet e kredisë. Rreziku i kredisë përfaqëson rrezikun materialisht më të rëndësishëm ndaj të cilit është i ekspozuar sektori bankar vendas. Është me rëndësi të jashtëzakonshme, veçanërisht në kontekstin aktual, vlerësimi i duhur i tij dhe sigurimi i nivelit kapitali që do të sigurojë mbulimin e humbjeve të mundshme të papritura të kredisë.

Me vendosjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, ndërmerren veprime parandaluese për parandalimin dhe reduktimin e rreziqeve sistematike, në shenjat fillestare të rritjes graduale të tyre në segmente të veçanta dhe mekanizmat mbrojtës të bankave për të absorbuar goditjet e mundshme forcohen më tej.

Bilancet e sektorit bankar tregojnë për themele të shëndosha, gjë e cila konfirmohet edhe nga stress testet e rregullta që tregojnë se bankat janë rezistente ndaj goditjeve të mundshme. Pozicionet kapitale të bankave janë të qëndrueshme me raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej rreth 17%. Cilësia e portofolit të kredisë është aktualisht e mirë me normë kredie me probleme në rreth 3%, e cila është më e ulët se niveli para pandemisë. Profitabiliteti i bankave është në nivel solid, që do të thotë se bankat kanë potencial të mjaftueshëm të brendshëm për të përmbushur kërkesat për kapital, duke përfshirë përmbushjen e normës së shresës kundërciklike së kapitalit prej 0,5%. Pritet që bankat, si deri më tani, të vazhdojnë të planifikojnë me kujdes nevojat e tyre kapitale dhe do t'i japin përparësi ruajtjes dhe forcimit të mëtejshëm të pozicioneve të kapitalit, në pajtueshmëri me rreziqet e ndërmarra në punë.

Banka Popullore do të vazhdojë të mbikëqyr nga afër si deri më tani rreziqet sistematike dhe do të rivlerësojë nivelin e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në baza të rregullta tremujore.